

TALKING ABOUT GENDER-BASED VIOLENCE



♀ **Më shumë se 1 në 3 femra** në mbarë botën (> 736 milionë gra) kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale nga partneri apo dhunë seksuale nga një jo-partner ose të dy rastet, të **paktën një herë në jetë**.

♀ **1 në 4 vajza** (15-19 vjeç) përjeton dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale nga partneri apo bashkëshorti (OBSH 2021)

♀ **Më shumë se 5 gra ose vajza VRIHEN në një orë** nga një anëtar i familjes së tyre (UN WOMEN 2022)

Dhuna gjinore është VEPËR PENALE, tashmë me bazë ligjore dënohet ashpër ndërsa Ndjekja Penale kryhet automatikisht edhe pa padi.¹

¹ Policia greke është e detyruar të nisë procedimin penal (dosje penale, prokuroria etj.) mjafton edhe një denonim **ANONIM** i thjeshtë. Në vitin 2018, me "Konventën e Stambollit" Greqia miraton ligjin N. 4531/2018 ku njihet & procedon me akt penal të ndjekur automatikisht të gjitha format e dhunës gjinore & familjare (stalking, dhuna financiare, gjymtimi i gjenitalit femëror, martesë e detyruar)

Flasim për dhunën me bazë gjinore (GBV): Për dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhe njerëzve që e përjetojnë për shkak të gjinisë ose orientimit seksual.

Dhuna me bazë gjinore është një fenomen **global**, ajo ushtrohet kryesisht nga meshkujt dhe djemtë, me viktima kryesisht gratë dhe vajzat, dhe ndodh kudo (në shtëpi, në familje, në shkollë, në punë, në internet, në çdo shoqëri).

Në **Greqi** mbizotëron termi dhuna në **familje**, pasi në masën dërrmuese të viktimitave apo e grave dhe vajzave që i kanë mbijetuar, autori është anëtar i familjes (bashkëshorti, vëllai, babai, xhaxhai a daja, vjehri, ish-bashkëshorti/partneri etj.)

JAM VIKTIMË E DHUNËS GJINORE?

Nëse keni përjetuar ndonjë nga format e mëposhtme të dhunës, **atëherë po ju jeni** viktimë e dhunës gjinore:

• **Seksuale:** përdhunim, ngacmimi seksual ose abuzim, trafikim i qenieve njerëzore (human trafficking), shfrytëzim seksual, martesë e detyruar.

• **Fizike:** vrasje e gruas, tortura, lëndime trupore/ goditje (shuplakë, shtyrje, shkelmimi etj.), privimi nga ushqimi dhe uji, gjymtimi i gjenitalit femëror, organeve etj.

• **Psikologjike:** psikologjike ose abuzim emocional, dhunë verbale (fyerje, kërcënime, sharje, të bërtitura, akuzë/kritika të pajustificuara), shkatërrim i sendeve personale, mungesa e lirisë & izolimi nga familja ose miqtë mjedisi, ndalimi i aktiviteteve, xhelozia, stalking (përndjekje abuzuese), pornografi hakmarrëse, pornografi pa konsensus.

• **Financiare:** pengesë aksesi në të ardhura - llogari bankare, mohim shansesh apo shërbimesh, moslejimi punësimiti.

KE FRIKË TË FLASËSH? Nuk je vetëm! Jemi shumë gratë që kemi mbijetuar dhe kemi forcë! MOS

Jeni në RREZIK TANI?

Nëse mund të FLASËSH dhe ke akses në TELEFON:

• Telefononi centralin **100** ose dërgoni një mesazh SMS falas (adresa, emri, lloji i urgjencës p.sh. "jeta ime është në rrezik")

• Telefono **15900** në linjën 24-orëshe SOS të Sekretariatit të Politikave Demografike dhe Familjare & Barazisë Gjinore (mbështetje psikosociale, këshilla ligjore, mikpritje në bujtina) ose dërgoni e-mail: sos15900@isotita.gr

• Telefononi ose dërgoni email në një nga **18 zyrat e Trajtimit të dhunës në familje të Policisë Greke:** ATHINË: 2144068271, 2105223970, dvoathens@astynomia.gr / PIREUS: 2104177602, dvopeiraios@astynomia.gr / ATIKA PERËNDIMORE: Peristeri: 2105717129, dvodyattikis@astynomia.gr ose Acharnes: 2102478004, 2102478017, gaev.aataxarnon@astynomia.gr / SELANIK: 2310253382, dvothess@astynomia.gr. Më shumë: <https://www.astynomia.gr/odigos-tou-politi>

• Aktivizoni aplikacionin **Panic Button** (buton paniku) në celular smartphone. Një aplikacion që lajmëron menjëherë policinë greke për gratë viktima të dhunës në familje për Atikën dhe Selanikun. Gjeneroni aplikacionin në komisariatet e policisë ose në agjencitë e dhunës në familje.

Nëse NUK mund të flisni lirshëm ose NUK keni akses në telefon:

• Bëni **SHENJEN PËR NDIHMË** në një videotelefonatë ose në rrugë, tek një kalimtar. Sinjali global për ndihmë është "burgosja" simbolike e gishtit të madh të dorës tuaj me gishtat e mbetur, siç tregohet në foto. Përsërit lëvizjen e gishtit lart e poshtë për të tërhequr vëmendjen.



Jeni DËSHMITAR i një incidenti apo **NJHNI viktimë të dhunës me bazë gjinore? RAPORTONI**, akoma edhe në mënyrë anonime. Nëse ndonjë mik apo i afërm, të flet për përvojën e saj/tij traumatike, **dëgjoni pa gjykuar**. Tregoni respekt dhe konfidencialitet. **Përpara se të veproini**, fillimisht flisni me dikë që është i specializuar për të marrë udhëzimet e duhura.

Jeni viktimë e dhunës me bazë gjinore PA DOKUMENTA?

Mos kini frikë. Ju nuk rrezikoheni me **DEPORTIM** ose nuk ju "marrin" kujdestarinë e fëmijëve. Viktimat e dhunës në familje **PA DOKUMENTA** (leje qëndrimi) **MBROHEN ZYRTARISHT** nga Ligji L. 4531/2018, dhe kanë të drejtë të përfitojnë leje qëndrimi për arsye humanitare. Nuk është e vlefshme e njëjta gjë për dëshmitarët e incidenteve të dhunës gjinore.

Jeni viktimë e dhunës gjinore dhe NUK KENI PARA?

Mos kini frikë. Mund të merrni **FALAS** asistencë mjekësore, psikosociale dhe ligjore nga struktura dhe shërbime të ndryshme (Qendra Konsulente të Bashkive, qendra "DIOTIMA" etj.)



NUMRA TELEFONI DHE LINK TË VLEFESHËM:

► **UDHËZUES XHEPI** për dhunën me bazë gjinore (GBV Pocket Guide) në 12 gjuhë: **Shkarkoni** aplikacionin nga Google Play ose App Store

► **LINJAT 24 orëshe:**

Ndihma e menjëhershme mjekësore: **166**
Trafikimi i qenieve njerëzore (TRAFFICKING): **11090**
Ndihma sociale direkte: **197**
Children SOS: **1056**
Mbrotjtja e fëmijëve: **1107**

► **Qendra Këshilluese të Bashkive** (27) **Bujtina** (18) në të gjithë Greqinë të Sekretariatit të Politikave Demografike dhe Familjare & Barazisë Gjinore (Qendra Athine: 2103317305-6). Më shumë në www.isotita.gr dhe www.womensos.gr

► **Qendra DIOTIMA:** Organizata jofitimprurëse e grave organizatë e specializuar në çështjet gjinore dhe barazisë: 2103244380 ose dërgoni email: helpdesk.diotima@gmail.com

#Produksion i Forumit Grek të Emigrantëve me mbështetjen e Fondacionit Rosa Luxemburg (nëntor 2023)

